



DREJTORIA E  
PËR GJITHSHMË  
E TATIMEVE



European Bank  
for Reconstruction and Development

Në bazë të shumës së pagave të përfituara në total nga të gjithë punëdhënësit, individit bën llogaritjet sipas skemës së mëposhtme:

Për shumën e pagave mujore deri 30.000 lekë tatimi është zero përqind;

Për shumën e pagave mujore nga 30.001 lekë - 130 000 lekë tatimi është 13 përqind e shumës mbi 30 000 lekë;

Për shumën e pagave mujore nga 130 001 lekë e më tepër tatimi është 13,000 lekë plus 23 përqind e shumës mbi 130,000 lekë.

Tatimi i llogaritur në këtë mënyrë për çdo muaj të vitit, mbledhet për të 12 muajt e vitit dhe hidhet në një shumë të vetme në kutinë 4 të deklaratës, e cila përfaqëson tatimin vjetor të llogaritur për pagat dhe shpërblimet.

Në kutinë 22 të deklaratës, individit do të shënojë shumën e tatimit të paguar dhe të mbajtur në burim nga çdo punëdhënësi gjatë gjithë muajve të vitit.

Diferenca midis tatimit të llogaritur, të shënuar në kutinë 4 të deklaratës, me shumën e tatimit të paguar, të mbajtur në burim nga punëdhënësit, të shënuar në kutinë 22 të deklaratës, përfaqëson shumën e detyrimit që duhet të paguajë individit në administratën tatimore për llogaritjen të tij vjetore nga punësimet.

Shuma e tatimit të llogaritur, të vendosur në kutinë 4 të deklaratës, në asnjë rast nuk mund të jetë më e vogël se tatimi i mbajtur në burim dhe i paguar nga punëdhënësi për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës gjatë vitit të vendosur në kutinë 22 të deklaratës.

Në rastin e individëve, të cilët në asnjë muaj të vitit nuk kanë qenë të dypunësuar, shumën e tatimit të llogaritur, të vendosur në kutinë 4 të deklaratës, është gjithmonë e barabartë me tatimin e mbajtur në burim dhe të paguar nga punëdhënësi për pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës gjatë vitit, të vendosur në kutinë 22 të deklaratës.

**Kujdes:**

Tatimi mbi pagat dhe shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit, duhet të llogaritet vetëm për pagat dhe shpërblimet e përfituara nga individit bazuar në një marrëdhënie të rregullt punësimi dhe sipas shumave të deklaruara nga punëdhënësi në listëpagesat respektive. Çdo e ardhur tjetër, e përfituar për shkak të marrjes pjesë në Komisionet e ndryshme, Komitetet, borde drejtuese këshilla mbikqyrëse etj, për të cilat është mbajtur paraprakisht 15% tatim në burim nga përfituesi i shërbimit dhe nuk janë deklaruar si paga nga ky i fundit, nuk duhet të llogariten si pagë e përfituar nga individit deklarues.

Totali i pagave dhe shpërblimeve të deklaruara nga individit deklarues duhet të përputhet me totalin e pagave dhe shpërblimeve të deklaruara për të nga punëdhënësit sipas deklaratave të listëpagesave respektive të administruara nga Administrata Tatimore.

**6. Shpenzimet që ke të drejtë të zbresësh nga tatimet e tua nëse bën deklaratë individuale të të ardhurave vjetore janë:**

- Interesat bankare të kredisë për shkollim, për vete, fëmijët dhe personat në kujdestari;
- Shpenzimet për mjekim, për vete, fëmijët dhe personat në kujdestari.

**Kujdes:**

- Deklarimi bëhet në mënyrë elektronike, si vijon:
  - Hyr në faqen elektronike të DPT-së në adresën: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al), duke përdorur numrin tënd personal (ID) si numër fiskal;
  - Kliko në menunë "e-Shërbime" dhe zgjidh nën-menunë "Për Individët";
  - Kliko në linkun "kliko këtu" dhe plotëso të dhënat në tabelën që të del në ekran.
- Për çdo të ardhur dhe shpenzim të zbritshëm të deklaruar duhet të kesh dokumentat përkatëse që konfirmojnë shumën e tyre;
- Dokumentat e të ardhurave dhe shpenzimeve ruhen 5 vjet, pas vitit të deklarimit.

# INFORMACION PËR TATIMPAGUESIT

## Individët

## Si qytetar ke rol të rëndësishëm në financat e shtetit

### 1. Kontribuon duke paguar:

- Tatime mbi të ardhurat e gjithëlojshme:
  - Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit;
  - Të ardhurat bruto nga dividendët si aksioner në shoqëri tregtare;
  - Të ardhurat bruto nga qeraja;
  - Fitimi kapital nga shitja e pasurisë së palujtshme në pronësi të deklaruesit;
  - Të ardhura bruto nga interesat bankare;
  - Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të palujtshme;
  - Shuma bruto të fituara nga lotaria apo lojëra të tjera të fatit.
  - Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuritë e tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike;
  - Fitim kapitali nga dhurimi;
  - Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart.
- Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të detyrueshme ose vullnetare;
- Taksa kombëtare dhe vendore, si p.sh.:
  - Taksa mbi ndërtesën ku je pronar, ose në rrethana të veçanta, përdorues i saj;
    - Ilogaritet duke shumëzuar çmimin e banesës, (më i larti midis atij të referencës dhe kontratës së shitjes) me 0,05%;
  - Taksa mbi tokën bujqësore;
  - Tarifa për pastrimin dhe largimin e mbeturinave.

### 2. Kontribuon edhe pa paguar, në luftën kundër informalitetit:

- Kërko që punëdhënësi të të sigurojë, sepse humbet pensionin, pagesën për lindje fëmije dhe shërbimin shëndetësor pa pagesë;
- Shëno çdo muaj në Librezë kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të paguara për ty nga punëdhënësi;
- Kërko dhe merr kuponin tatimor për çdo blerje që bën, sepse:
  - Sigurohesh që ke paguar vlerën reale të mallit apo shërbimit;
  - Ndikon në përmirësimin e shërbimeve publike;
  - Gjobjetesh nëse nuk e ke marrë; dhe
  - Duke marrë kuponin ndalon shitësin e mallit ose ofruesin e shërbimit që të fshehë detyrimet për shtetin.

### 3. Detyrimet për punëtorë shtëpie si punëdhënësi i tyre:

- Kur si kryefamiljar, punëson individë në punë të tilla si:
  - Kujdestar për fëmijët,
  - Shërbime të tjera familjare: kuzhinier, pastrues, roje, ndihmës për të moshuarit, etj.,
- Duhet të regjistrohesh punëtorin e familjes në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT) me:
  - Një kërkesë me shkrim;
  - Formularin e regjistrimit që të jepet në DRT;
  - Dokumentin tënd të identitetit;
  - Kopje të marrëveshjes së punës ku minimalisht përcaktohen: numri i sigurimit shoqëror i punëtorit, data e fillimit të punës, afati i punësimit dhe paga mujore bruto.
- Duhet të pajisesh me dokumenta që përcaktojnë dhe pasqyrojnë detyrimet tatimore:
  - Certifikatë Regjistrimi (NIPT) në emrin tënd (brenda 2 ditësh nga paraqitja e kërkesës);
  - Librezë të kontributeve të sigurimeve për punëtorin, nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore me shënimin: "Të siguruar vetëm për pension dhe sigurim shëndetësor".

#### Kujdes:

- Ndryshimin/largimin e punëtorit të familjes e bën nga llogaria jote elektronike në DPT, duke klikuar në e-shërbime.

### 4. Tatimet i paguan ti, punëdhënësi ose paguesi i burimit të të ardhurave

Nivelet sipas llojit të tatimeve, dhe paguesit e tyre sipas natyrës së të ardhurave janë si vijon:

Tabela 1. Detyrimet tatimore të individëve dhe paguesit e tyre

Nr.	Lloji i detyrimit	Shkalla tatimore	Shuma mbi të cilën zbatohet shkalla tatimore	Paguesi i tatimit
1.	Tatimi mbi pagën tënde dhe të punëtorit të familjes	0% 13% 23%	Paga 0 - 30,000 lekë/muaj; Pjesa e pagës në kufirin 30,001-130,000 lekë/muaj; Pjesa e pagës mbi 130,000 lekë/muaj	Punëdhënësi yt për ty, dhe Ti për punëtorin e familjes
2.	Kontributi yt për sigurime shoqërore	9.5%	Paga mujore në kufirin 24,000-105,850 lekë/muaj	Punëdhënësi
3.	Kontributi yt për sigurime shëndetësore	1.7%	Paga faktike por jo nën kufirin 24,000 lekë/muaj	Punëdhënësi
4.	Tatimi mbi të ardhurat e tua të tjera	15%	Të ardhurat bruto ose fitimi kapital (diferenca e çmimit të shitjes me atë të blerjes)	Ti, kur i arkëton nga individët dhe Paguesi kur ai është subjekt tatimpagues
	Kontribute për sigurime shoqërore të punëtorit të familjes	2,750 lekë/muaj	Tarifë fikse mujore	Ti, Çdo 3 muaj (20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor; 20 Janar)
	Kontribute për sigurime shëndetësore të punëtorit të familjes	748 lekë/muaj	Tarifë fikse mujore	Ti, Çdo 3 muaj (20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor; 20 Janar)

### 5. Për tatimet e paguara gjatë vitit duhet të bësh edhe deklaratën individuale të të ardhurave vjetore, brenda datës 30 prill të vitit pasardhës, nëse:

- Shuma vjetore e të ardhurave (brenda dhe jashtë vendit), pa përfshirë kompensimet sociale dhe pasurore ose dëmshpërblimet e ndryshme, është më e madhe se 2 milionë lekë në vit;
- Ke të ardhura më pak se 2 milionë lekë në vit por do që të përfitosh uljen e detyrimeve tatimore duke zbritur shpenzimet e lejueshme për këtë qëllim.

Çdo individ, i cili është i detyruar të paraqesë Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave, duhet të bëjë kujdesin e duhur për plotësimin e saktë të të dhënave të deklaratës dhe sidomos për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, në rastet kur individit përfiton dy apo më shumë paga në një muaj nga punëdhënësi të ndryshëm.

Tatimi i llogarit mbi pagat dhe shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët, është kuti e lirë boshe në deklaratë dhe plotësohet nga vetë deklaruuesi.

Individi deklaruues, do të llogarisë tatimin mbi të ardhurat personale nga pagat dhe shpërblimet për të gjitha të ardhurat nga pagat që përfitohen gjatë muajit, edhe në rastin kur ai i përfiton këto paga nga punëdhënësi të ndryshëm. Në rastin kur shuma e të ardhurave të përfituara gjatë muajit nga dy apo më shumë paga tek punëdhënësi të ndryshëm e kalojnë vlerën që tatohet me zero përqind (30,000 lekë), tatimi do të llogaritet mbi totalin e të ardhurave mujore nga pagat (totali i të ardhurave nga pagat tek të gjithë punëdhënësit).